



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 935/Prot.
2

Tiranë, më 27 / 6 /2017

Lënda : *Opinion për bërjen publike të rekomandimeve të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit lidhur me kandidatët për institucionet e rivlerësimit*

Drejtuar: **Z. Arben CICI, Drejtor Kabinetit të Kryetarit**

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

TIRANË

I nderuar Z. Cici,

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur "Zyra e Komisionerit") u njoh me kërkesën tuaj, administruar me nr. 935 prot, datë 19.06.2017 dhe me rrethanat e parashtruara në të. Paraprakisht, vlerësojmë angazhimin tuaj në kuadër të garantimit të transparencës që meriton procesi i reformës në drejtësi duke pasur parasysh impaktin e lartë që ka për opinionin publik shqiptar ky proces, si dhe kujdesin e treguar në mbrojtjen e të drejtës së privatësisë nga ana tjetër. Gjithashtu, gjejmë rastin të shprehim vlerësimin tonë për ndërgjegjësimin e shoqërisë civile për një pjesëmarrje aktive në procese me një interes të lartë publik si ai i reformës në drejtësi.

Referuar dokumentacionit të kërkuar me shkresën nr. 1681 prot., datë 09.06.2017 nga Qendra Res Publica, Shoqata ELSA dhe Organizata Ad Litem në kuadër të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" (në vijim "Ligji për të Drejtën e Informimit"), dëshirojmë të saktësojmë se Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit është një organ, detyrat e të cilit parashikohen në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, dhe më konkretisht në Nenin B të Aneksit të saj. Rekomandimet e kryera nga ky Operacion i përcillen institucioneve të tjera të përfshira në procesin e reformës në drejtësi siç është dhe Kuvendi i Republikës së Shqipërisë i cili qartësisht përkufizohet si Autoriteti Publik sipas Ligjit për të Drejtën e Informimit.

Sa më sipër bën që, edhe në mungesë të një parashikimi të shprehur lidhur me publikimin e rekomandimeve të dhëna nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit, aktet e nxjerra në kuadër të veprimtarisë së Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit të konsiderohen informacion publik në kuptim të pikës 2 nenit 2 të Ligjit për të Drejtën e Informimit sipas të cilit "*informacion publik konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të*

funkcionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik” dhe si të tillë, të jenë të aksesueshëm për personat ose subjektet juridike që shfaqin interes për njohjen me to.

Sa i përket informacionit që përmbajnë këto rekomandime, vetë Neni A i Aneksit të Kushtetutës, duke pasur parasysh impaktin dhe interesin e lartë publik që paraqet procesi i reformës në drejtësi, përcakton se kryerja e procesit të rivlerësimit, i cili përbën thelbin e kësaj reforme, imponon disa kufizime të të drejtave themelore të parashikuara në Kushtetutë, pjesë e të cilave është edhe respektimi i të drejtës së privatësisë.

Zyra e Komisionerit, duke marrë parasysh sa është parashtruar më sipër, vlerëson se rekomandimet e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit përcjellë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, përbëjnë informacion publik në kuptim të pikës 2 të nenit 2 të Ligjit për të Drejtën e Informimit dhe për pasojë duhet të vihen në dispozicion të palëve të interesuara.

Jo vetëm kaq, por Zyra e Komisionerit, nisur nga interesi i lartë publik që paraqet procesi i reformës në drejtësi dhe duke pasur parasysh nevojën për një transparencë sa më të gjerë dhe të plotë lidhur me këtë proces, me qëllim shmangien e çdo forme spekulimi lidhur me të dhe veçanërisht me mënyrën e përzgjedhjes dhe seleksionimit të kandidatave të paraqitura, vlerëson se bërja publike nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë vetëm i rekomandimeve të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, pa bërë publike të dhënat e vëna në dispozicion të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit nga institucionet publike shqiptare me qëllim hartimin e këtyre rekomandimeve, nuk do t’i garantonte publikut transparencën e duhur lidhur me procesin në fjalë. Zyra e Komisionerit vlerëson se Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, si dhe të gjitha institucionet e tjera të përfshira në procesin e vlerësimit të kandidatave të paraqitura për institucionet e vlerësimit kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve, siç janë Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK), Autoriteti për Informimin me Dosjet e Ish Sigurimit të Shtetit (AIDSSH), Qendra Kombëtare e Biznesit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Gjykatat, Prokuroria, etj., nisur gjithmonë nga interesi i lartë publik që paraqet procesi i reformës në drejtësi, duhet të publikojnë në faqet e tyre zyrtare në internet si pjesë e programeve të transparencës, vlerësimet dhe opinionet e dhëna për kandidaturat e paraqitura në përputhje me nenin 7 të Ligjit për të Drejtën e Informimit.

Duke shpresuar të kemi qenë shterues në opinionin tonë, ju falenderojmë për bashkëpunimin.

